



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:265493

Datë: 12.09.2024

Numri i dokumentit: 06154453

P.nr.440/22

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni me bashkëpunëtorin profesional Besart Prishtina, në çështjen penale kundër të pandehurve L.B. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Xh.T. me seli të zyrës në Prishtinë, dhe të pandehurit B.A. me adresë në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. H.S. me seli të zyrës në Prishtinë për shkak të veprës penale Shmangia mashtruese nga detyrimet nga neni 92 (b) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/1, të datës 30.01.2004, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.37/11, të datës 31.05.2013, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, jashtë seancës, me datë 12.09.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. Hedhet aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.37/11, të datës 31.05.2013 dhe pushohet procedura penale kundër të pandehurit L.B. nga i ati N..., e ëma M..., i data e lindjes... në Prishtinë, ku edhe banon, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe të pandehurit B.A., nga i ati S..., e ëma Z..., data e lindjes..., në fshatin V..., komuna e Mitrovicës, me adresë të banimit në Prishtinë, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për shkak të veprës penale Shmangia mashtruese nga detyrimet nga neni 92 (b) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/1, të datës 30.01.2004, për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

II. Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

III. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur aktakuzën PPS.nr. 37/11, të datës 31.05.2013, ndaj të pandehurit L.B. me adresë në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Xh.T. me seli të zyrës në Prishtinë, të pandehurit N.A. me adresë në Prishtinë, të pandehurit F.R. me adresë në Prishtinë, dhe të pandehurit B.A. me adresë në Prishtinë, të cilin sipas

autorizimit e përfaqëson Av. H.S. me seli të zyrës në Prishtinë, për shkak të veprës penale Shmangia mashtruese nga detyrimet nga neni 92 (b) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/1, të datës 30.01.2004.

Gjykata Themelore Mitrovicë me aktgjykimin P.nr.904/13, të datës 27.05.2014, të pandehurit L.B., N.A. dhe B.A. i ka shpallur fajtor për veprën penale Shmangia mashtruese nga detyrimet nga neni 92 (b) i Rregullores së UNMIK-ut nr.2004/1, të datës 30.01.2004, duke i'i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vitesh, i cili nuk do të ekzekutohet nëse të pandehurit nuk kryejnë vepra të njëjta apo ngjashme penale në afat prej 3 viteve. Me aktgjykimin e njëjtë, të pandehurin L.B. e ka liruar nga akuza për veprën penale Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 paragrafi 1 dhe 2 të KPK-së, ndërsa të pandehurin F.R. e ka liruar nga akuza për veprën penale Ndihmë në kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të autorizimeve në ekonomi nga neni 236 paragrafi 1 dhe 2 të KPK-së dhe nenit 25 paragrafi 1 të KPK.

Me aktgjykimin PA1.nr.1166/14, të datës 09.02.2015 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe të mbrojtësve të të dënuarve janë refuzuar si të pabazuara ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar. Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin PML.nr.189/2015, të datës 27.10.2015, pjesërisht i ka miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë duke anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1166//14, të datës 09.02.2015, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, në rivendosje, ka nxjerr aktgjykimin PA1.nr.1376/15, të datës 26.01.2016, me të cilin ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe të mbrojtësve të të pandehurve janë refuzuar si të pabazuara, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar. Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin PML.nr.128/2016, të datës 20.09.2016, ka miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve N.A. dhe B.A., dhe përkitazi me L.B. sipas detyrës zyrtare, ashtu që ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.904/13, të datës 27.05.2014 dhe atë të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1376/2015, të datës 26.01.2016, dhe çështjen i'a ka kthyer gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, por e lidhur me parimin *reformatio in peius*.

Gjykata Themelore Mitrovicë, me aktvendimin P.nr.127/16, të datës 02.03.2022 ka pushuar procedurën penale kundër të pandehurit N.A. për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Çështje në fjalë, në Gjykatën Themelore Mitrovicë – Dega Vushtrri është pranuar në muajin 27.12.2022.

Gjykata, pas pranimit të çështjes dhe shqyrtimit të së njëjtës ka arritur në përfundim se në këtë rast është arritur afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale për të pandehurit L.B. dhe B.A..

Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/1, të datës 30.01.2004, nenit 92, pika (b) është paraparë “Nëse një person në lidhje me çfarëdo malli, në çfarëdo mënyre është i përfshirë në shmangie

mashtuese nga pagesa e çfarëdo detyrimi të cilëve u nënshtrohen mallrat, atëherë ai do të dënohet: (b) me një gjobë e me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet atëherë kur shuma e detyrimeve të shmangura është mbi 15.000 €, dhe ato mallra në lidhje me të cilat është kryer kundërvajtja do t'i nënshtrohen ndaljes dhe konfiskimit.”. Pra me dispozitën e sipër cekur, për veprën penale për të cilën akuzohen të pandehurit është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vite.

Me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës nr.2003/25, të datës 06.07.2003, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur dyshohet se është kryer vepra penale e mësipërme, me nenin 90 paragrafi 1, pika 4) është përcaktuar se *“Me përjashtim të rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse nuk kanë kaluar afatet e mëposhtme: Pesë vjet nga kryerja e veprës së dënueshme me më shumë se tre vjet burgim;”,* ndërsa me nenin 91 paragrafi 6 është përcaktuar se *“Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).”*

Sipas aktakuzës që është objekt shqyrtimi në këtë çështje, pretendohet se i pandehuri L.B. veprën penale nga neni 92, pika (b), të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/1, të datës 30.01.2004, e ka kryer në mes të datave 17.03.2006 dhe 10.04.2007, ndërsa i pandehuri B.A. veprën penale nga neni 92, pika (b), të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/1, të datës 30.01.2004, e ka kryer në mes të datave 04.11.2007 dhe 31.10.2008, ashtu që, nga koha kur Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës pretendon se të pandehurit kanë kryer veprën penale të mësipërme e deri në kohën e nxjerrjes së këtij aktvendimi kanë kaluar më tepër se më tepër se gjashtëmbëdhjetë vite, respektivisht më tepër se pesëmbëdhjetë vite, pra më tepër se dyfishi i kohës së përcaktuar me nenin 90 paragrafi 1, pika 4).

Gjykata, duke pasur parasysh dispozitat ligjore lidhur me dënimin e parashikuar për veprën penale për të cilën ngarkohen të pandehurit, afatin e parashkrimit absolut të ndjekjes penale dhe kohën e kaluar nga data kur Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës pretendohen se janë kryer veprat penale, ka arritur në përfundim se në këtë çështje, ndaj të pandehurve L.B. dhe B.A., lidhur me veprën penale të mësipërme ka arritur afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale, dhe konform dispozitave ligjore të sipër cekura se aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës duhet të hedhet dhe ndjekja penale ndaj të pandehurve duhet të pushohet.

Aktvendimin gjykata e mori konform nenit 357 paragrafi 1, pika 1.3 të KPPK-së, ku është përcaktuar se *“Gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me aktvendim e hedh aktakuzën kur: ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen.”* dhe paragrafit 2 ku është përcaktuar se *“Aktvendimin mbi hedhjen e aktakuzës mund ta merr gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor.”*

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, Gjykata e mori konform nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimin mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, Gjykata e mori në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 462 par.1 dhe par.3 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA VUSHTRRI
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.440/22, datë 12.09.2024

Gjyqtar i vetëm gjykues
Agron Maxhuni

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 10 (dhjetë) ditësh prej ditës së pranimi, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.